

URDHËR
Nr. 525, datë 30.10.2018

**PËR AUTORIZIMIN E NËNSHKRIMIT TË KËRKESAVE SOCIAL-JURIDIKE TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
TË ARKIVAVE**

Në mbështetje të nenit 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 26.11.2003, “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit” dhe të Kodit të Procedurave Administrative,

URDHËROJ:

1. Z. Armando Boçe, drejtori (i ngarkuar me detyrë) i Drejtorisë së Evidencës Qendrore dhe Komunikimit, autorizohet të nënshkruajë kërkesat social-juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.
2. Specimeni i firmës së z. Boçe të dërgohet në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido